



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljezo / Prodato Received / Delivery	30.03	2022	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	1726/2022		11/1



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 28 /2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
2. Kryesuesi i Sekretariatit në Organin Shqyrtues të Prokurimit obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Kryesuesit të Sekretariatit në Organin Shqyrtues të Prokurimit
- Menaxherit të Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punimjen / Prodato Received / Delivery	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	1726/2022		1/18



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT

PËR VITIN 2020

në

ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Prishtinë, prill 2022

PËRMBAJTJE

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	5
FUSHA E MONITORIMIT.....	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT.....	7

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Ketë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;

Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit për të vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës monitoruese më datë 08.03.2021 në prezencë të Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të dokumenteve relevante (kopje), si në vijim: Rregulloren Nr.01/2015, për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Organin Shqyrtues të Prokurimit; Pushimet Vjetore të stafit në vitin 2020; Pushimet mjekësore të stafit për vitin 2020; Plani vjetor i trajnimit të nëpunësve civil për periudhën shkurt 2019- Dhjetor 2019; Shkresë zyrtaret që kanë ndjekë trajnimet në vitin 2020; Vendimi me numër protokollit 199 i datës 12.03.2021, për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi me nr.prot:90/20 i datës 31.01.2020, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Dosje e konkursit “Zyrtar i Teknologjisë Informative”, Dosje e konkursit “Ekspert shqyrtues”; Dosja e konkursit RN00005626 për pozitën “Përkthyes Shqip Serbisht”, Dosje e Konkursit për pozitën e punës “Asistente Ekzekutive e Paneleve Shqyrtuese; Dosja e konkursit për pozitën e punës “ Zyrtar i lartë ligjor”; dosja personale e nëpunësit civil Zyrtar për pranimin e ankesave dhe i protokollimit; Dosja personale e

Plani Vjetor i Trajnimit të nëpunësve civil shkurt 2019-dhjetor 2019; Vendim mbi lejimin e pushimit të lehonisë për pozitën Menaxher e Personelit i datës 01.10.2019; Lista e Personelit të OSHP-së viti 2020; Propozimi për status për zyrtarët në MAP; Propozimet e institucioneve për klasifikimin e vendeve të punës të shqyrtuara dhe miratuara nga Komisioni i përbashkët MAP-MF miratuar nga ministri i administratës publike dhe ministri i financave si dhe aprovuar nga Qeveria. MAJ 2016; Formular të dhënat për të punësuarit në shërbimin civil të Kosovës niveli Qendror 2020; Formulari i planit individual të personelit për vitin 2020 OSHP, Emalin e datës 15.03.2022; Njoftimin e datës 30.01.2020 për Kandidatin e Suksesshëm për pozitën Zyrtar i Larte Ligjor: Njoftimin e datës 30.01.2020 për kandidatin e suksesshëm për pozitën Ekspert/Shqyrtues; Njoftimin e datës 31.01.2020: Emalin e datës 15.03.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të protokollit 1375/19 të datës 20.11.2019; Dokumentin e identifikimit të kandidatit Kartelën bankare të kandidatit

Shkresën e datës 30.08.2019; Diplomën nr.511667 e datës 30.08.2019; CV e kandidatit lidhur me përvojën e punës: Pasqyra e Llogarisë për periudhën 30.11.2002 deri

Shkresën e datës 31.10.2019; Diplomën me Nr. 5208 të datës 08.09.2017; Certifikatën e datës 27.02.2016; Certifikatën e periudhës Korrik-2016; Certifikatën e datës 24.03.2016; Vërtetimin për mbarimin e punës praktike të datës 07.12.2015; Certifikatën për periudhën Nëntor 2015; Pasqyrën e llogarisë/ Trustin të kandidatit për periudhën kohore 30.11.2002 deri me 26.11.2019; Emalin e datës 15.03.2022; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të protokollit 15/20 të datës 13.01.2019; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Certifikatën themelore profesionale për prokurim të vlefshme për vitet 2021-2023; Diplomën me Nr.4581 të datës 20.09.2016 të kandidatës Certifikatën e datës 10-13.12.2021; Emalin e datës 15.03.2022;

TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë të Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje OSHP) ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr.01/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, në Organin Shqyrtues të Prokurimit, nga data 16.04.2015. Sipas deklarimeve të Menaxheres së personelit, sistematizimi i vendeve të punës është në harmoni me Rregulloren nr.01/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Numri i stafit të OSHP-së për vitin 2020 ka qenë 23, ndërsa numri i pozitive të lira ka qenë 2.

- Gjatë vizitës monitoruese Këshilli ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil dhe atë për pozitat: *Zyrtar për të Hyra dhe Kthimin e Depozitave, Përkthyes i Gjuhës Angleze, Ekspert Shqyrtues, Zyrtar i Teknologjisë Informative dhe Zyrtar për Pranimin e Ankesave dhe Protokoll.*
- Këshilli duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ushtrues detyre.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka të përfunduar procesin e deklarimit të statusit.

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, gjegjësisht mostrave të marra ka gjetur se dosjet e personelit në përgjithësi kanë qenë të kompletuara, përjashtimisht që nuk përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, siç parashihet me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht nenin 4 paragrafi 3 dhe 4 përcaktohet se: *3. Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, bashkëlidhur kësaj*



rrëgulloreje; 4. Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale.

Të gjitha institucionet që punësojnë zyrtarë publikë, janë të detyruar të krijojnë dhe administrojnë dosjen personale të çdo të punësuarit në institucionin e tyre (dosja individuale). Dosja personale e zyrtarit publikë është individuale dhe krijohet që nga data e punësimit dhe përmban të dhëna: profesionale, personale, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera sipas shtojcës 1.1 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurorit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, në mënyrë që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Këshilli bazuar në deklarinë e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore si dhe dëshmitë e ofruara, ka konstatuar se gjatë vitit 2020 Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka zhvilluar shtatë (7) procedura të rekrutimit, të cilat kanë filluar në shtator të vitit 2019, por pas Njoftimit të datës 07.10.2019 të Ministrisë së Administratës Publike, OSHP-ja sipas Njoftimit Publik të datës 14.10.2019 ka pezulluar që të gjitha procedurat e rekrutimi, duke vazhduar me tej pas shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MAP Nr.02/ZPS-06 të datës 09.01.2020, gjegjësisht të gjitha procedurat e rekrutimit të pezulluara kanë vazhduar në muajin janar 2020 sipas Ligjit Nr.03/L149 për Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, si mostra për analizim ka marrë dëshmitë lidhura me procedurat e rekrutimit për pozitat si në vijim:

- Përkthyesi Gjuhës Shqipe dhe Serbe,
- Zyrtar i Lartë Ekzekutiv
- Zyrtar i Lartë Ligjor,
- Zyrtar i Teknologjisë,
- Ekspert shqyrtues.

Nga dëshmitë dhe dokumentacioni nuk vërehet së OSH-ja gjatë vitit 2020 ka pasur të punësuar me marrëveshje të veçanta.

Lidhur me këtë fushë, Kolegji ka gjetur:

E GJETURA 2 : Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil gjatë analizimit të dosjeve të konkurrimit ka konstatuar se:

- për pozitën e punës *Zyrtare për Teknologji*, sipas konkursit me numër reference RN00005624, i shpallur me datë 13.09.2019 një (1) pozitë pune, si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: *Diplomë universitare: shkenca kompjuterike, dhe minimumi dy vite përvojë pune profesionale*, ndërsa bazuar në dokumentacionin e kandidates së përzgjedhur Kolegji ka gjetur se sipas diplomës me Nr.1409 të datës 25.01.2018, e njëjta ka përfunduar studimet bechellor i Shkencave të Inxhinierisë kompjuterike me datë 27.12.2017, respektivisht kandidatja e përzgjedhur nuk ka pasur gjithsej dy vjet pune profesionale pas diplomimit deri në datën e mbylljes së Konkursit me datë 02.10.2019.
- për pozitën e punës *Përkthyes nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas*, sipas konkursit me numër reference RN00005626, i shpallur me datë 13.09.2019, një (1) pozitë, si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: *Diplomë universitare: gjuhe serbe, ekonomik, juridik, psikologji gjuhe dhe letërsi shqipe, minimumi tri vite përvojë pune profesionale, njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve...* ndërsa nga analizimi i dosjes së aplikimit të kandidates së përzgjedhur Kolegji ka gjetur se sipas diplomës me Nr.5211 të datës 06.03.2017 e njëjta ka përfunduar studimet bechellor i Psikologjisë me datë 13.02.2017, respektivisht kandidatja e përzgjedhur nuk ka pasur gjithsej tri vjet pune profesionale pas diplomimit deri në datën e mbylljes së konkursit.
- për pozitën e punës *Ekspert Shqyrtues*, sipas konkursit me numër reference RN00005620, i shpallur me datë 13.09.2019 tri (3) pozita, si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: *Diplomë universitare: Ekonomik, Juridik, Administratë Publike, Shkenca Politike apo Shkenca teknike si dhe tri vite përvojë pune profesionale*, ndërsa sipas Raportit Përmbledhës të Komisionit rekrutues të datës 29.10.2020, kandidatja është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë 88.1 % duke u renditur si e para, kandidatja është vlerësuar me 84.2 %, si kandidatja e dytë, është vlerësuar me 83.3 %, duke u renditur si kandidati i tretë, kandidatja është vlerësuar me 77.75 %, renditur si kandidatja e katërt dhe është vlerësuar me 68.3 pikë duke u listuar si kandidatja e pestë, kurse sipas Njoftimit të datës 30.01.2020 lidhur me këtë pozitë punë janë pranuar vetëm tre kandidatë dhe atë:

dhe ndërsa sipas organit të punësimit një pozitë tjetër është marrë nga lista e bursistëve sipas Kontratës së marrëdhënies së punës me numër protokoll 1375/19 të datës 20.11.2019 në kohëzgjatje prej 20.11.2019 deri me 20.11.2022 bazuar në Marrëveshjen për financim IPA 2014.

-për pozitën e punës *Zyrtar i Lart Ligjor*, sipas konkursit me numër reference RN00005621, i shpallur me datë 13.09.2019, tri (3) pozita, si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: *Diplomë universitare: fakulteti juridik dhe tri vite përvojë pune profesionale*, ndërsa sipas Njoftimit të datës 30.01.2020 për këtë pozitë është përzgjedhur vetëm një kandidat edhe atë

i vlerësuar me gjithsej 75.35 % të pikëve, kurse dy vende tjera janë caktuar dhe të cilët ju është lëshuar kontratë me numër protokoll 1376/19 të datës 20.11.2019 për dhe numër protokoll 15/20 të datës 13.01.2019 (viti konsiderohet gabim) për

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatit të përzgjedhur Kolegji ka konstatuar si i njëjti sipas Diplomës me numër 51000 të datës 18.10.2017 ka diplomuar me datë 13.06.2017 në fakultetin juridik, dhe mbi këtë konstatim rrjedh së ankuesi nuk ka tri vite përvojë profesionale të pune pas diplomimit.

-Lidhur me pozitën *Zyrtar i Lartë Ekzekutiv*, i shpallur sipas Konkursit me nr.refernce RN00005622 të datës 13.09.2019, Komisioni i vlerësimit ka shpallur si fituese kandidaten mirëpo Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të OSHP përmes vendimit me numër protokoll 106/2020 të datës 16.03.2020 ka aprovuar ankesën e kandidatës dhe ka anuluar konkursin për këtë pozitë me arsyetimin se në listën e ngushtë nuk kanë qenë tre kandidate ashtu siç është përcaktuar me nenin 29 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, ndërsa nga analizimi i dosjes lidhur me këtë procedurë konkurrimi kolegji ka gjetur se KZKA ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material sepse në listën e ngushtë të datës 21.01.2020 janë përfshirë vetëm dy kandidatë.

Ashtu siç u konstatua me lartë, Kolegji vlerëson së organi i punësimit nuk ka vepruar në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për shërbimin civil, pasi që kandidatet e përzgjedhur për pozitën Përkthyes i Gjuhës Shqipe dhe Serbe, Zyrtar i Lartë Ligjor dhe Zyrtar i Teknologjisë nuk kanë plotësuar kriterin e përvojës së punës. Ndërsa përkitazi me emërimin në pozitat e shpallura për Zyrtar të Lartë Ligjor dhe Ekspert shqyrtues nga lista e bursistëve, Kolegji konstaton së përjashtimisht kontratës me e lidhur me 13 janar 2020, dy kontratat tjera janë të lidhura në muajin nëntor 2019, pra para se të behet përzgjedhja e kandidateve sipas konkurseve të shpallura dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson së organi i punësimit nuk ka mundur të bëjë pranimin e

këtyre kandidateve të cilat fare nuk kanë aplikuar në këto konkurse. Bazuar në praktiken institucionale pranimi i bursistëve sipas Marrëveshjes Financiarë IPA 2014, është bërë vetëm bazuar në listën e identifikuar nga Qeveria/ministria përkatëse dhe sistemimin e tyre në vende të lira, andaj sipas gjykimit të Këshillit një emërim të tillë ka cenuar parimin e konkurrencës dhe mundësisë se barabartë për kandidatet aplikues dhe që pretendohet që kanë plotësuar kushtet për pozitat e shpallura.

Rekomandim nr.2 : Rekomandojmë Kryesuesin e Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, që të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore për eliminimin e shkeljeve të konstatuar dhe që me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidateve për shërbim civil të veprohet në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit NR. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji në procesin e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit sipas Vendimit me numër protokoli 199 të datës 12.04.2021 ka të themeluar Komisionin Disiplinor, që sipas vlerësimit të Këshillit përbërja e tij është në pajtim me nenin 49 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Sipas menaxheres së Burimeve Njerëzore në vitin 2020 në Organin Shqyrtues të Prokurimit nuk është zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore ndaj nëpunësit civil.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit ka themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave sipas Vendimit me numër protokoli 90/20 të datës 31.01.2020, ndërsa gjatë vitit 2020. Këshilli nga dokumentacioni i pranuar ka gjetur se në vitin 2020, KZKA ka shqyrtuar dhe ka vendosur për ankesën e kandidates të datës 27.02.2020, përmes vendimit me numër protokoli 106/2020 të datës 16.03.2020. Ndërsa drejtpërdrejtë në

KPMSHCK është pashtuar një (1) ankesë me numër të7 regjistrimit A.nr.124/2020 e datës 07.05.2020, për të cilin Këshilli nuk ka vendosur në mungesë të anëtarëve të Këshillit.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Sipas deklarimit të Menaxheres së Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, janë bërë vlerësimet e rezultateve të punës për nëpunësit civil për vitin 2020, ndërsa një (1), nëpunës është për vlerësimin e rezultateve në punën provueses.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në kopje fizike dhe elektronike. Në vitin 2020 gjashtëmbëdhjetë (16) nëpunës civil kanë realizuar pushimet vjetore, dy rast pushim pa pagesë, dhe dy (2) raste të pushimit të lehonisë. Bazuar në analizimin e mostrave të marra, pushimet vjetore janë të shoqëruar me kërkesë paraprakë për pushim, pushimi mjekësor është i shoqëruar me dëshmi mjekësore dhe po ashtu vendimet për pushim të lehonisë kanë qenë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, kështu që mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në vitin 2020 nuk ka pasur asnjë transferim të stafit.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ka të punësuar gjithsej njëzetetë (23) zyrtar Publik respektivisht nëpunës civil.

- përfaqësimi gjinor: 11 nëpunës meshkuj dhe 12 nëpunëse femra;
- përfaqësimi etnik: 1 nëpunës i komunitetit boshnjak;
- përfaqësimi i personave me nevoja të veçanta: s'ka të punësuar;

E GJETURA 3: Rrjedhimisht Kolegji vlerëson se nuk kemi përfaqësimin etnik në pajtim me nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil me të cilin është përcaktuar se: *Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit...* dhe nenin 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përshihet se : *Në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.*

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Kryesuesin e Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, që me rastin e rekrutimit të stafit të ri, të ketë parasysh respektimin e dispozitave ligjore lidhur me përfaqësimin etnik respektivisht nenin 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit në vitin 2020 nuk ka pasur asnjë rast sa i përket pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës.

Nuk ka këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të marra si mostër dhe sipas deklarimit të udhëheqësit të njësisë përgjegjëse ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka raste ku nëpunësi civil në të njëjtën kohë mbanë dhe ndonjë post tjetër publikë.

Nuk ka këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshilli për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil bazuar në deklarimin e udhëheqësit të njësisë përgjegjëse ka gjetur se në Organin Shqyrtues të Prokurimit në vitin 2020 nuk ka asnjë nëpunës ndaj të cilit është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës.

Nuk ka këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka përgatitur planin e trajnimeve për vitin 2020, ku sipas evidencës së pranuar në vitin 2020 trajnimet kanë ndjekur 17 nëpunës civil dhe mbahet evidencë lidhur me trajnimet e mbajtura.

Nuk ka këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, bazuar në deklaratimet e menaxheres së personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ka gjetur se vijimi në punë mbahet në formë elektronike, nëpunësve civil realizojnë pagat sipas koeficientit të përcaktuar me Akt Emërimit, po ashtu asnjë nëpunës civil nuk kompensohet me ndonjë shtesë pritej pagës bazë.

Nuk ka këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

14. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar së nuk ka pasur rekomandime për vitin 2019 përkitazi me OSHP-në sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka qenë funksional për shkak të mungesës së korumit, dhe po ashtu siç u konstatua me lartë, në vitin 2020 ka pasur vetëm një ankese e për të cilën Këshilli nuk ka vendosur për shkak të mungesës së anëtareve.

16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar tri (3) të gjetura dhe ka tri (3) rekomandime për veprim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Organit Shqyrtues të Prokurimit që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetare e Kolegjit

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Menaxherit të Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.

